



Datë: 02.06.2025

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

Thirrje publike për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekt-propozimeve dhe programeve të Organizatave Jo Qeveritare në Komunën e Fushë-Kosovës.

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Fushë-Kosovës u bënë thirrje të gjitha organizatave jo qeveritare të Regjistruara në divizionin e OJQ-ve që veprimtarit e tyre i zhvillojnë në Komunën e Fushë-Kosovës, të aplikojnë për mbështetje financiare për fazën e II-të 2025.

1. Klubet, Shoqatat, OJQ-të dhe individët në përputhje me këtë thirrje publike mund të aplikojnë me projekte-propozimet që do të kontribuojnë në avancimin dhe fuqizimin e Kulturës, Rinis dhe Sportit në këto lami:
 - Kulturë:
 - Art vizual (fuqizimi i artistëve të rinj, instalime ne hapësira publike, ekspozitë); Manifestime (shënimi i datave historike; shënimi i festave kombëtare dhe ndërkombëtare dhe shënimi i datave tjera me rëndësi në Komunën e Fushë-Kosovës).
 - Rini:
 - Promovimi i vullnetarizmit, integrim i grupeve Rinore dhe atyre të marginalizuara.
 - Sport:
 - Masivizimi i sportit, përkrahje financiare e klubeve sportive, ngritje e nivelit profesional të klubeve sportive, aktivitete edukative me simpatizant me qëllim të evitimit të dhunës, turnire dhe kultivimit të vlerave fisnike të sportit.
2. Klubet, Shoqatat, OJQ-të dhe individët mund të aplikojnë vetëm me një projekt në kuadër të kësaj thirrje.
3. Periudha e zbatimit të projektit duhet të jetë minimumi 1 muaj dhe maksimumi 6 muaj. Organizatat Jo qeveritare duhet po ashtu të kenë të kryer transaksionet financiare sipas legjislacionit në fuqi, në përputhje me rregullat e kontabilitetit si dhe të kenë përmbushur detyrimet ndaj Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe të gjithë ofruesve tjerë të mbështetjes financiare publike;
4. Të drejtë aplikimi për projektet e tyre kanë Klubet, Shoqatat, OJQ-të dhe individët që janë të regjistruara në regjistrin e Organizatave Jo Qeveritare në Republikën e Kosovës dhe të cilat veprojnë në Komunën e Fushë-Kosovës para datës së publikimit të thirrjes publike

5. Propozimet duhet të dorëzohen vetëm në formularin e paraparë sipas udhëzuesit për aplikim, që do të jenë në dispozicion në faqen e internetit të ofruesit të mbështetjes financiare në web-faqen e komunës linku <https://fushekosove.rks-gov.net/> , ndërsa thirrjet për sqarime dhe çështje tjera që lidhen me aplikimin mund të bëhen vetëm në mënyrën elektronike në e-mail adresën agron.breznica@rks-gov.net , jo më vonë se 3 ditë pune para mbylljes së thirrjes publike.

Afati për dorëzimin e propozimeve për mbështetjen financiare është prej data: 02.05.2025 dhe përfundon me datën: 09.05.2025.

Vërejtje: Klubet, Shoqatat dhe OJQ-të, përfitues të mbështetjes financiare, obligohen të dorëzojnë raportin narrativ dhe financiar me dëshminë e faturave të rregullta me kupon fiskal, dëshmitë e pagesave të pagave dhe kontributeve, 15 ditë pas përfundimit të projektit.

Sqarim: Klubet, Shoqatat dhe OJQ-të, të cilët nuk kanë përmbyllë raportin e subvencioneve të viteve paraprake nuk kanë të drejtë të përfitojnë nga subvencionet e Komunës së Fushë Kosovës në këtë thirrje.

Lista e dokumenteve të detyrueshme të thirrjes publike:

Për individë :

- Kopjen e letërnjoftimit
- Vërtetimin/konfirmimin e llogarisë bankare (nuk pranohet kopje e kartelës bankare)
- Formulari i projekt-propozimit
- Formulari i propozim buxhetit

Për OJQ/KLUBE:

- Formulari i projekt-propozimit (për aplikacionin online)
- Formulari i propozim buxhetit (për aplikacionin online)
- Kopja e certifikatës së regjistrimit të OJQ-së (e skanuar në formatin PDF)
- Kopja e certifikatës së numrit fiskal (e skanuar në formatin PDF)
- Konfirmimi dhe pasqyra e llogarisë bankare së paku 1 vit (e skanuar në formatin PDF- nuk pranohet kopja e kartelës bankare)
- Vërtetimi i Administratës Tatimore.

Sqarim shtesë : Të gjitha dokumentet e cekura më lartë duhet të jenë në dy kopje fizike në zarfe të ndara.

Aplikacionet mund të dorëzohen në Zyrën Pritëse, si dhe me anë të postës, në adresën:

Fushë Kosovë, 12000, Rr. Tahir Zemaj, objekti i Komunës, departamenti i DKRS-së

Aplikacionet mund të dorëzohen në Zyrën Pritëse, si dhe me anë të postës, në adresën:

Fushë Kosovë, 12000, Rr. Tahir Zemaj, objekti i Komunës, departamenti i DKRS-së

Aplikacionet, të cilat nuk e kanë dokumentacionin e kompletuar do të diskualifikohen.
Dokumentet nuk pranohen pas mbylljes së thirrjes publike.

Dokumentacioni i kompletuar duhet të dorëzohet në dy zarfe të mbyllura .

Formularët duhet të plotësohen me anë të kompjuterit.

Ana e jashtme e zarfeve duhet ta përmbaj:

- Emrin e thirrjes publike,
- Emrin dhe adresën e plotë të aplikuesit
- Emrin e plotë të projektit
- Mbishkrimin "Mos e hap para hapjes zyrtare".

